



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KUÇOVË

Datë 02 . 02 .2023

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

OBJEKTI I PROCEDURËS:

“Shërbimi i pastrimit, grumbullimit dhe transportit në venddepozitim të mbetjeve urbane”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Kodi CPV: 90610000-6 “Shërbimet pastrimi dhe fshirjeje të rrugëve”

VLERA E FONDIT LIMIT:

- **Fondi limit vjetor : 37 303 458.22** *(tridhjetë e shtatë milion e treqind e tre mijë e katërqind e pesëdhjetë e tetë presje njëzetë e dy) lekë pa tvsh.*
- **Fondi limit total për 4 (katër) vite : 149 213 832.88** *(njëqind e dyzetë e nëntë milion e dyqind e trembëdhjetë mijë e tetëqind e tridhjetë e dy presje tetëdhjetë e tetë) lekë pa tvsh.*

Burimi i financimit: nga buxheti i Bashkisë Kuçovë, sipas VKB Nr 85 datë 22.12.2022 me objekt “Për Miratimin e Buxhetit Afatmesëm” 2033 – 2025, si dhe të konfirmuar nga Prefekti i Qarkut

Berat me shkresën Nr 956/2 të dates 09.01.2023 të protokolluar pranë nesh me shkresën Nr 3980/2 Prot të dates 11.01.2023.

Lloji i procedurës së prokurimit do të jetë **“E Hapur mbi kufirin e Lartë Monetar”**, me afat 48 muaj ose 4 (katër) vite, mbështetur në nenin 42 të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” dhe sipas nenin 47, e VKM nr. 285, dt. 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, si dhe të nenit 11 Kufijtë monetarë, pika 1 gërma a) ku kufiri i lartë monetar për kontratat publike të shërbimeve dhe të mallrave është 40 000 000 (dyzet milionë) lekë.

.

Bazuar nga sa më sipër duke qenë se shërbimi i pastrimit, grumbullimit dhe transportit në venddepozitim të mbetjeve urbane është kontratë komplekse që kërkon financim shumëvjeçar, e cila nuk mund të zbatohet brenda vitit buxhetor dhe ku financimi i saj është i garantuar, Autoriteti Kontraktor ka vendosur kryerjen me afat 48 muaj të shërbimit.

Ky investim do të kryhet në bazë të Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr 85 datë 22.12.2022 “Për miratimin e buxhetit afatmesëm 2023-2025”, si dhe të konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Berat me shkresën Nr 956/2 të date 09.01.2023 protokolluar pranë Bashkisë Kuçovë me Nr 3980/2 Prot të datës 11.01.2023.

Gjykohet e arsyeshme aplikimi i kontrates shumëvjeçare, duke qenë se në rastin konkret kontrata shumë vjeçare garanton dhe siguron efektivitet në lidhje me shpejtësinë e realizimit në kohë të shërbimit, si dhe qendrueshmeri në kryerjen me cilësi të shërbimit (e provuar kjo nga kontratat e mëparshme që ka lidhur autoriteti kontraktor Bashkia Kuçovë për këtë shërbim me afat 4 vjeçar). Autoriteti kontraktor argumenton se lidhja e një kontrate shumëvjeçare, rrit efikasitetin dhe shmang vonesat në ofrimin në kohë të këtij shërbimi ndaj qytetarëve, të cilat mund të vijnë për shkaqe të ndryshme objektive që nuk varen nga autoriteti kontraktor, ndërkohë që domosdoshmëria për këtë shërbim është me rëndësi shumë të madhe për komunitetin, duke marrë në konsideratë faktin që ky shërbim përbën interes publik të rëndësishëm së veçantë, me karakter të përditshëm dhe të vazhdueshëm.

Kërkesat e autoritetit kontraktor janë realizimi i vazhdueshëm, eficient dhe me cilësi i shërbimit të pastrimit, grumbullimit dhe transportit në venddepozitim të mbetjeve urbane.

Kontratat shumë vjeçare krijojnë një raport më të mirë ndërmjet kërkesës së Autoritetit Kontraktor për shërbime cilësore dhe kostos që kanë operatorët ekonomik për ti ofruar këto shërbime me kapacitete optimale.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit

publik” i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor **Bashkia Kuçovë** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3

b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas shtojcës 9

Argumentimi : Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen me Nenin 76 “Kriteret detyruese për skualifikim”, nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetdeklarimit” dhe neni 83 “Sigurimi i ofertes”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në mbështetje të Nenit 26 “Formulari përmbledhës i vetdeklarimit” dhe nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik i ndryshuar :

Neni 82, i LPP “1. *Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik*”.

Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”,

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik sipas Shtojcës 9.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”,

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar :

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron minimale vjetore për 3 (tre) vitet e fundit financiare të konfirmuara nga Administrata Tatimore, e cila të ketë një vlerë jo më të ulët se 40% e vlerës së fondit limit që prokurohet. Në dokumentacionin e lëshuar nga administrata tatimore, duhet të jetë e pasqyruar vlera e xhiros për secilin vit të periudhës së kërkuar në kërkesat për kualifikim.

Në dokumentacionin e lëshuar nga administrata tatimore, duhet të jetë e pasqyruar vlera e xhiros minimale për secilin vit të periudhës së kërkuar në kërkesat për kualifikim, konkretisht për të tre vitet e fundit financiare të aktivitetit të operatorit ekonomik ofertues.

Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.

Autoriteti kontraktor, referuar parashikimeve të legjislacionit të prokurimit publik, rezervon të drejtën të verifikojë vërtetësinë e informacionit të paraqitur në procedurën e prokurimit, lidhur me plotësimin e kërkesës për kualifikim për kapacitetin ekonomik dhe financiar.

Deklaratë me shkrim nga operatori ekonomik ofertues.

Në të gjitha rastet e deklaramit të pasaktë apo të rremë, do të veprohet konform parashikimeve të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin Publik”, si dhe parashikimeve të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 2/a të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë :

Autoriteti kontraktor, në përcaktimin e vlerës së xhiros minimale vjetore (dhe konkretisht jo më pak se 40% e vlerës së fondit limit të kontratës që prokurohet) ka mbajtur në konsideratë nenin 43 pika 2 gërma b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” ku shprehimit thotë se :

Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare .

2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë :

- a) **dyfishin e vlerës së përlllogariturtë kontratës ose lotit¹, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar;**
- b) *vlerën e përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar;*
- c) 40 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në procedurat e prokurimit “Shërbim konsulence”.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros qëmund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore”: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njejtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhëne tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji”.

Duke qenë se ligji për prokurimit publik parashikon se për xhiron minimale vjetore autoriteti kontraktor nuk mund të kërkojë më shumë se dyfishin e vlerës së përlllogariturtë kontratës ose lotit², në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, njësia e prokurimit gjykon se për

të rritur konkurrencën midis ofertuesve ka vendosur vlerën prej jo më pak se 40% e vlerës së fondit limit që prokurohet.

2.2.2. Operatorët ekonomikë ofertues duhet të japin informacione në bilancet e tyre vjetore për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare dhe konkretisht 2019, 2020 dhe 2021 të cilat duhet të jenë të konfirmuara nga Administrata Tatimore, si dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, pika "c", të Ligjit nr. 10091, datë 5.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare". Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: "Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

Ndërsa shoqërimi me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, është bërë duke iu referuar parashikimit në nenin 41 shkronja c" të Ligjit nr. 1009/2009: "*Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga ekspertë kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë **dy prej tre treguesve të mëposhtëm:** i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin*

ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël".

2.2.3 Vërtetim për shlyerjen e detyrimeve dhe taksave vendore për vitin 2022 për çdo vend të ushtrimit të aktivitetit apo njësi të qeverisjes vendore në të cilën ushtron aktivitet sipas QKB-së duke mbajtur në konsideratë dhe përcaktimet e Ligjit Nr 9632, datë 31.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, lidhur me afatet e kryerjes së pagesave të caktuara nga njësitë e vetëqeverisjes vendore.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomik duhet të vetdeklarojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar.

Për Taksat Lokale

Në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 9 përcaktohet se :

Në taksat vendore përfshihen :

1. Taksa vendore mbi biznesin e vogël.
2. Taksa mbi pasurinë e paluajtshme, në të cilën përfshihen taksa mbi ndërtesat dhe taksa mbi tokën bujqësore.
3. Taksa e fjetjes në hotel.
4. Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja.
5. Taksa mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme.
6. Taksa e regjistrimit të përvitshëm të mjeteve.
7. Taksa për zënien e hapësirave publike.
8. Taksa e tabelës.
9. Taksa të përkohshme.

Në nenin 14 po këtu, përcaktohet se : “1. Taksa paguhet në katër këste të barabarta. Kësti i parë paguhet brenda datës 20 prill. Kësti i dytë jo më vonë se data 20 korrik, kësti i tretë jo më vonë se data 20 tetor dhe kësti i fundit jo më vonë se data 20 janar e vitit të ardhshëm fiskal”.

Bazuar mbi sa më sipër kërkesa e autoritetit kontraktor për pagesën e taksave lokale për vitin 2022 është në përputhje me ligjin 9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i cili detyron operatorët ekonomik ofertues që të dorëzojnë minimalisht vërtetimin për pagesën e tre kësteve (konkretisht deri në këstin e tretë i cili paguhet jo më vonë se data 20 Tetor të viti pasardhës).

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit ushtrimorë duke filluar nga data e publikimit të njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 35 % të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe konkretisht.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a)** Për përvojën e mëparshme të realizuar me ente publike, operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b)** Për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi : Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 “Kërkesat për kualifikim”, të Ligjit Nr 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” pika 4..”*në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomik zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomik të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontrata e*

zbatuara në të shkuarën”, si dhe nenit 41, pika 3, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, duke filluar nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomik ofertues të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë jo më të vogël se 35% të vlerës së fondit limit që prokurohet, që është vlera brenda kufirit maksimal të përcaktuar në nenin e mësipërm.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë :

Përvoja e mëparshme është një element shumë i domosdoshëm që garanton autoritetin kontraktor se operatorët ekonomik mbi bazën e vlerës së kontratave të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie. Vlera e kërkuar nuk sjell kufizim të konkurrencës dhe është në masën 35% të fondit limit.

2.3.2 Operatorët ekonomik ofertues, duhet të disponojnë fuqi punëtore për realizimin e kontratës me sukses prej minimalisht **20 (njëzetë)** persona për 3 (tre) muajt e fundit duke filluar nga data e publikimit të njoftimit të kontratës.

Kandidatët apo operatorët ekonomikë ofertues, duhet të paraqesin listëpagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për të gjithë periudhën e kërkuar sipas formularit E/Sig-25, për kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni tatimor, si dhe sipas legjislacionit në fuqi.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomik duhet të vetdeklarojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Dokumenti i kërkuar më sipër do të paraqitet përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Autoriteti kontraktues është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi ndaj dhe përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktues, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës së prokurimit. Referuar legjislacionit në fuqi, është përcaktuar se autoriteti kontraktues kërkon dëshmi për fuqinë punëtore me qëllim që të garantohet për realizimin me sukses të kontratës.

Si dhe referuar përmasave të kontratës që do të do të prokurohet, specifikimeve teknike, fondit limit, afatit të zbatimit të saj, si dhe kohëzgjatjes së parashikuar për realizimin e shërbimit gjithësej 48 (dyzetë e tetë) muaj ose 4 (katër) vite, njësia e prokurimit vlerëson se numri i punonjësve të kërkuar nga ana e autoritetit kontraktor në rastin konkret, garantohet për zbatimin e kontratës me sukses duke krijuar besueshmerinë dhe qëndrueshmëri të punonjësve tek operatorët ekonomik, si dhe duke mos sjellë vonesa në zbatimin e saj.

Lidhur me përcaktimin e numrit të punonjësve, njësia e prokurimit ka mbajtur në konsideratë Rekomandimin e APP Nr 4916/2 Prot të datë 14.07.2022, pika 3 ku përcaktohet se autoritetet kontraktore duhet të hartojnë kërkesat e veçanta të kualifikimit në përputhje me nenet 77 të LPP dhe 78 të VKM, si dhe legjislacionit të fushës përkatës, duke argumentuar dmosdoshmërinë e tyre në çdo rast.

Bazuar mbi rekomandimin e APP, njësia e prokurimit ka hartuar analizën teknike ku parashikohet fuqia punëtore duke u bazuar në preventivin e shërbimeve si dhe afateve kohore të parashikuar në grafikun e punimeve dhe mbi bazën e analizave përkatëse ka përcaktuar numrin e saktë të punonjësve që nevojiten për zbatimin e kontratës me sukses dhe në kohë.

Sipas preventivit përmbledhës për shërbimin e pastrimit, dhe sipas Analizës së kostot nr 1 në zërin fshirje me fshesë e rrugëve dhe blloqeve të banimit me një sipërfaqje prej 189 400 m2, për Bashkinë Kuçovë janë të nevojshëm 24 (njëzetë e katër) punëtor për kryerjen me efikasitet të këtij shërbimi.

Sipas Analizës së kostos nr 2 është parashikuar lagja e rrugëve me autobot në sasinë 320 herë në vit, dhe për realizimin me sukses të këtij shërbimi nevojitet minimumi 1 (një) shofer.

Sipas Analizës së kostos nr 3, është parashikuar larja e kontenierëve 69 herë në vit, dhe për realizimin me sukses të këtij shërbimi nevojit minimumi 2 (dy) punonjës.

Sipas Analizës së kostos nr 4, është parashikuar heqja e mbetjeve inerte dhe të biodegradueshme dhe depozitimit të tyre në vendin e përcaktuar nga autoritetit kontraktor, dhe për realizimin me sukses të këtij shërbimi nevojit minimumi 3 (tre) punonjës për përdorimin e kamionçinës vetshkarkues e hapur ku njeri prej tyre do të jetë shofer, dhe 2 (dy) punonjës ndihmës për ngarkimin dhe shkarkimin e tyre.

6 (gjashtë) punonjës janë të domosdosshëm për përdorimin e 2 (dy) mjeteve teknologjike 10-11 ton për shërbimin e pastrimit në Kuçovë.

Ku çdo mjet ka një shofer dhe 2 (dy) punonjës specialist për ngritjen e kontenierëve.

Nisur nga sa më sipër argumentuar, njësia e prokurimit gjykon se ka parashikuar një numër minimal punonjësish për realizimin me sukses të shërbimit të pastrimit duke miratuar një numër prej 20 (njëzetë) punonjësish që duhet të kenë operatorët ekonomik ofertues në listëpagesat e tyre.

2.3.3 Kandidatët, operatorët ekonomikë ofertues duhet të përcaktojnë me anë të një deklaratë (nga Administratori i Shoqërisë) Drejtuesin Teknik të shërbimit të pastrimit, i cili duhet të jetë i diplomuar në Inxhinieri mjedisi/biologji mjedisore/ ose diplomë Ekuivalente në fushën mjedisore, shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtëm :

1. Librezë punë (përkatëse)
2. Diplomë
3. CV përkatëse
4. Kontratë pune midis tij dhe operatorit ekonomik (e vlefshme)
5. Të figurojë në listëpagesa e operatorit ekonomik ofertues.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomik duhet të vetdeklarojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Dokumenti i kërkuar më sipër do të paraqitet përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkojnë sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi : Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në piken pikës 4, të nenit 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” : *Aftësia profesionale e operatorëve*

ekonomik për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës” dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

Në VKM-në nr.42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, Kreu IV “Drejtuksi teknik i shoqërisë dhe papajueshmëria me këtë detyrë”, pika 1, ku parashikohet shprehimisht: “Drejtuksi teknik i shoqërisë ;

a) Drejtuesi teknik i shoqërisë është personi me arsimin universitar përkatës (përcaktuar në lidhjen nr.5) dhe me përvojë pune jo më pak se 5 vjet nga diplomimi. Për personat që kanë mbaruar universitetin me mesatare note nga 9.0 e lart ose ekuivalent (për studime të përfunduara në shtete të huaja) afati të jetë jo më pak se 3 vjet nga diplomimi.

b) Licenca profesionale e shoqërisë kategorizohet mbështetur në diplomimin dhe përvojën personale të drejtuesit/drejtimesve teknikë, kërkesave të tjera që caktohen në këtë rregullore dhe vlerësimit të komisionit për dokumentacionin e paraqitur.

c) Marrëdhëniet e drejtuesit teknik me shoqërinë rregullohen sipas kontratës individuale të punës.”

Njësia e prokurimit gjykon se synimi parësor i autoritetit kontraktor është vërtetimi se ofertuesi disponon staf të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës objekt prokurimi.

Drejtuksi Teknik i shërbimit të pastrimit është përgjegjës për zbatimin e këtij shërbimi në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës.

Duke ju referuar zërave të preventivit dhe specifikimeve teknike të tij është shumë e rëndësishme për AK, kapaciteti dhe përvoja e mëparshme në punë e drejtuesit teknik të këtij shërbimi që vërtetohen në CV përkatëse të tij.

AK gjykon se Drejtuesi Teknik i cilit kërkohet me diplomë ekuivalente në fushën mjedisore është në përputhje me frymën e ligjit të prokurimit publik, dhe i shërben njëkohësisht zbatimit të kontratës me sukses dhe në kohë.

Duke qenë se ky shërbim do të kryhet për një mjedis të pastër të qytetit të Kuçovës dhe Njësive Administrative, kërkesa e mësipërme e autoritetit kontraktor nuk shkon përtej asaj se çfarë është e nevojshme, por garanton këtë të fundit që kontrata do të zbatohet në përputhje me legjislacionin mjedisor në fuqi.

2.3.4 Operatorët ekonomikë ofertues duhet të kenë në stafin e tyre teknik të punësuar, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, diplomë, CV dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë:

Inxhinier Agromjedisi - minimalisht 1 (një)

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomik duhet të vetdeklarojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Dokumenti i kërkuar më sipër do të paraqitet përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohej sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi : Kërkesa e mësipërme **2.3.4** është përcaktuar bazuar në piken 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” *Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës” dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe Ligjit nr. 10 431, date 9.6.2011”Per mbrojtjen e mjedisit”.*

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës, projektin, relacionet dhe raportet teknike, specifikimet dhe zërat e shërbimit që do të realizohen dhe do të monitorohen në vazhdimësi nga ky lloj inxhinieri. Nevoja për inxhinierin agromjedisi në objekt është e diktuar nga përvoja e mëparshme, legjislacioni për mjedisin etj.

Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët. Ky inxhinier është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e shërbimit. Operatorët ekonomik duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën.

Duke qënë se për shërbimin e pastrimit, dhe konkretisht për mbledhjen e kontenierëve të mbetjeve urbane dhe depozitimit të tyre në vendin e caktuar nga autoriteti kontraktor dhe konkretisht në Fërmen Partizane (Njësia Administrative Perondi), në përbërje të tyre ka mbetje

ushqimore, eksperiencia e inxhinierit të sipërcituar del e nevojshme për trajtimin dhe depozitimin e tyre.

Për sa më sipër njësia e prokurimit gjykon se kriteri për disponimin nga ana e ofertuesve për një inxhinier Agromjedis, i shërben qëllimit të autoritetit kontraktor për zbatimin e kontratës.

2.3.5 Operatorët ekonomik ofertues duhet të kenë në stafin e tyre teknik të punësuar, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë ofertuese, për periudhën (tre muajt e fundit) duke filluar nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës :

- Specialist të kualifikuar sipas formimit profesional për ngritjet manuale me dorë - minimalisht 1 (një).
- Specialist të kualifikuar sipas formimit profesional për rrezikun dhe menaxhimin e agjentëve kimikë – minimalisht 1(një).

Në plotësimin e këtij kriteri për kualifikim duhet të paraqitet edhe dokumenti apo çertifikata e formimit profesional. Ky dokumentacion duhet të jetë i lëshuar nga institucione apo organe shtetërore ose kompani të licensuara në fushën e formimit profesional. Në të gjitha rastet, dokumentacioni apo çertifikata duhet të jetë e njohur dhe e miratuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, për kurset e formimit profesional.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomik duhet të vetdeklarojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Argumentimi :Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” : Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës” dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Lidhur me kërkesën e autoritetit kontraktor për disponimin nga ana e ofertuesve të 1 (një) specialisti të kualifikuar sipas formimit profesional për ngritjet manuale me dorë, njësia e

prokurimit gjykon se për sa kohë në preventivin e shërbimit është parashikuar mbledhja dhe transporti i mbejteve urbane në venddepozitimin e mbetjeve zona I, II dhe zona III, i cili do të kryhet me mjete teknologjike, specialisti i kërkuar nevojitet për afrimin e kontenierit dhe ngritjen e tij pranë mjetit teknologjik për shkarkimin e mbetjeve urbane. Për sa më sipër argumentuar, kërkesa e AK është në përputhje me objektin e kontratës nga ku procesi i mësipërm i punës nuk kryhet nga çdo punonjës, por kryhet nga persona të aftë dhe të trajnuar duke shmangur çdo rrezik të mundshëm.

Lidhur me kërkesën e autoritetit kontraktor për disponimin nga ana e ofertuesve të 1 (një) specialisti të kualifikuar sipas formimit profesional për rrezikun dhe menaxhimin e agjentëve kimikë, njësia e prokurimit gjykon se për sa kohë në preventivin e shërbimit është parashikuar lagia e kontenierëve për 69 ditë në vit, dhe ku lagia dhe pastrimi i tyre do të bëhet me agjentë kimikë, kërkesa e mësipërme e AK është në përputhje me objektin e kontratës.

2.3.6 Operatorët ekonomik ofertues duhet të kenë në stafin e tyre teknik të punësuar të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, dhe të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë ofertuese për periudhën 3 (tre) muajt e fundit duke filluar nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, si dhe të paraqesë dëshmi të kualifikimit apo certifikatë që provon se ofertuesi ka pjesë të stafit të tij teknik të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar për sistemin e menaxhimit të sigurisë dhe të shëndetit në punë, konform standartit ISO 45001.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomik duhet të vetdeklarojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Argumentimi :Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” : *Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës” dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.*

Në hartimin e kriterit të mësipërm, njësia e prokurimit gjykon se duke marrë parasysh proceset e punës për një shërbim kaq kompleks dhe delikat, ku punëtorët ballafaqohen çdo ditë me problematika të ndryshme, si ngritja e kontenierëve dhe shkarkimi i tyre, pastrimi i mbetjeve të ngurta me kamionçinë dhe shkarkimi dhe depozitimi i tyre në vendin e caktuar nga autoriteti kontraktor, nevojitet një punonjës që të jetë i certifikuar sipas standartit ISO 45001 për sistemin e

menaxhimit të sigurisë dhe të shëndetit në punë, konform legjislacionit përkatës social dhe të punës.

2.3.7 Operatorët ekonomik ofertues duhet të kenë në stafin e tyre teknik të punësuar, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë ofertuese, me dëshmi të kualifikimit apo certifikatë që provon se ofertuesi ka pjesë të stafit të tij teknik të paktën 1 (një) Inxhinier të certifikuar për përdorimin e pajisjeve të punës dhe të pajisjeve mbrojtëse.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomik duhet të vetdeklarojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Argumentimi : Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” : *Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës” dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.*

Lidhur me kriterin e mësipërm, njësia e prokurimit gjykon se duke marrë parasysh proceset e punës për një shërbim kaq kompleks dhe delikat, ku punëtorët ballafaqohen çdo ditë me problematika të ndryshme, si ngritja e kontenierëve dhe shkarkimi i tyre, pastrimi i mbetjeve të ngurta me kamionçinë dhe shkarkimi dhe depozitimi i tyre në vendin e caktuar nga autoriteti kontraktor, nevojitet një inxhinier që të jetë i certifikuar për përdorimin e pajisjeve të punës dhe të pajisjeve mbrojtëse duke shmangur çdo rrezik të mundshëm dhe duke i paraprirë çdo problem.

2.3.8 Operatorët ekonomike ofertues, duhet të kenë staf mbështetës teknik, për realizimin e shërbimit të objektit të prokurimit të paktën 1 (një) specialist për sistemin e menaxhimit të mbetjeve mjedisore/urbane, për të cilin duhet të paraqiten në procedurën e prokurimit publik kontrata e punës e vlefshme, si dhe dokumenti ku të provohet kërkesa e mësipërme për kualifikim.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomik duhet të vetdeklarojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Argumentimi : Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” : Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës” dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Lidhur me kriterin e mësipërm njësia e prokurimit gjykon se duke marrë parasysh proceset e punës për këtë shërbim, operatori ekonomik fitues ka detyrimin e venddepozitimit të mbetjeve urbane, nevojitet (një) specialist për sistemin e menaxhimit të mbetjeve mjedisore/urbane, duke kryer proceset e sistemimit të tyre në vendin e përcaktuar nga autoriteti kontraktor dhe konkretisht në Fermën Partizane.

- 2.3.9** Operatorët ekonomik ofertues duhet të kenë të punësuar në shoqëri të paktën 2 (dy) persona të pajisur me çertifikata të aftësimi profesional për mjetet teknologjike, për të cilët duhet të paraqitet në tender kontrata e punës e cila duhet të jetë e vlefshme, dëshmia profesionale që provon dhe vërteton kërkesën për kualifikim, si dhe të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë për periudhën 3 (tre) muajt e fundit duke filluar nga publikimi i njoftimit të kontratës.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomik duhet të vetdeklarojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Argumentimi : Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” : Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës” dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Lidhur me kriterin e sipërcituar, njësia e prokurimit gjykon se ka kërkuar një numër minimal punonjesisht për drejtimin e mjeteve teknologjike.

Akoma më tej, duke u bazuar dhe në analizën e kostos të hartuar nga autoriteti kontraktor, në pikën 2.3.14 janë parashikuar 2 mjete teknologjike me kapacitetet 10-11 ton për proceset e punës që do të kryhen për mbledhjen dhe transportimin e mbetjeve urbane.

Duke marrë parasysh faktin që për autoritetin kontraktor ky shërbim do të kryhet në Bashkinë Kuçovë, dhe 3 (tre) Njësive Administrative Perondi, Kozare dhe Lumas, kërkesat e hartuar nga ky i fundit, janë minimale dhe i shërbejnë qëllimit të AK, duke njohur aftësitë dhe kapacitetet e operatorëve ekonomik ofertues gjithmonë për realizimin e kontratës me sukses.

2.3.10 Operatorët ekonomikë ofertues duhet të kenë në stafin e tyre, i cili duhet të figurojë në listëpagesat e shoqërisë për periudhën 3 (tre) muajt e fundit, të paktën një person të çertifikuar për menaxhimin e mbetjeve të ngurta, për të cilin duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme, si dhe dokumentacion apo çertifikimi që provon kërkesën e mësipërme për kualifikim.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomik duhet të vetdeklarojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Argumentimi : Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” : Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës” dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Lidhur me kriterin e sipërcituar, njësia e prokurimit gjykon se dhe një tjetër proces i rëndësishëm pune është dhe heqja e mbetjeve inerte dhe të biodegradueshme, konkretisht sipas zërit 6 të preventivit përmbledhës.

Të gjitha mbetjet e kontenierëve, inerteve dhe mbetjeve të ngurta, kryhet i njëjti proces depozitimi në vendin e caktuar nga autoriteti kontraktor. Për mirëmenaxhimin e venddepozitimit të mbetjeve urbane, AK gjykon se kërkesa e mësipërme i shërben qëllimit të autoritetit kontraktor.

2.3.11 Operatorët ekonomik ofertues duhet të kenë staf teknik mbështetës për realizimin e shërbimit të objektit të prokurimit, të paktën 1 (një) punonjës ekspert që përmbush kriteret për të qenë koordinator në fushën e sigurisë dhe të shëndetit në punë, sipas kërkesave të ligjit nr. 10237, datë 18.02.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë”, si dhe V.K.M. nr. 312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores Për sigurinë në kantier”, konkretisht për grumbullimin dhe transportin e mbetjeve urbane, për fshirjen me fshesë të rrugëve, trotuar dhe sheshe, si dhe për lagjen e rrugëve dhe shesheve me makine teknologjike/autobot, për të cilin duhet të paraqiten në procedurën e prokurimit publik kontrata e punës e vlefshme, si dhe dokumenti apo çertifikata ku të provohet kërkesa e mësipërme për kualifikim.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomik duhet të vetdeklarojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Argumentimi : Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” : *Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës” dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.*

Njësia e prokurimit gjykon se për punonjësin e kërkuar më sipër, garantohet autoriteti kontraktor që subjektet ushtrojnë veprimtarinë e tyre në përputhje me V.K.M-në Nr. 312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores për sigurinë në kantier”.

Duke marrë në konsideratë faktin që ky shërbim do të kryhet në territorin e Bashkisë Kuçovë dhe Njësive Administrative, punonjësi i kërkuar më sipër garanton AK për zbatimin e kontratës në kohë dhe me sukses duke shmangur çdo të papritur ose ndonjë aksident të mundshëm, si dhe duke i ardhur për ndihmën e parë të nevojshme në rastet e ndonjë aksidenti të mundshëm, për sa kohë shërbimi do të jetë permanent për një afat 4 vjeçar.

Njësia e prokurimit e gjykon se kërkesa e mësipërme është në përputhje me objektin e kontratës, për shkak se garantimi i ekspertit së mbrojtjes e shëndetit në punë nga çdo rrezik dhe të papritur në punë dhe dokumentat përkatëse të personave përgjegjës i shërbejnë autoritetit për të krijuar bindjen dhe besueshmëri për realizimin e kontratës.

Kriteri i mësipërme lidhen ngushtësisht me objektin e kontratës duke i shërbyer autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për

përmbushjen e plotë të kontratës, si dhe duke lehtësuar operatorët ekonomik ofertues në përmbushjen e këtij kriteri.

2.3.12 Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencë të vlefshme të shoqërisë e lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit QKB, për grumbullim dhe transportim të mbetjeve urbane (kodi III.2.B).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, “Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor” të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, dhe nenin 39 pika 6, gërma a), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar,

Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose

Në këtë kuptim, për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit zotërojnë kapacitetin teknik e konkretisht licencë profesionale të shoqërisë për realizimin e shërbimeve, ku të përfshihen ndër të tjera edhe transporti i mbetjeve të ngurta (inerte).

Në nenin 5 të ligjit nr.10081 datë 23.02.2009 “Për Licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, parashikohet se “Ushtrimi i veprimtarive dhe kryerja e veprimeve në territorin e Republikës së Shqipërisë janë, si rregull, të lira dhe nuk i nënshtrohen licencimit apo autorizimit, përveçse kur parashikohet ndryshe me ligj”.

Sa më sipër, konstatohet se gjatë kryerjes së shërbimeve, referuar edhe parashikimeve të preventivit, kërkesa e autoritetit kontraktor për licensim është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe në përputhje me natyrën dhe volumin e kontratës pasi krahas shërbimeve, operatori ekonomik fitues i kontratës duhet të kryejë edhe transportin e mbetjeve urbane, transportin e dherave dhe inerteve sipas zërave të preventivit, i cili referuar kuadrin ligjor në fuqi duhet të kryhet nga subjekte të licencuara.

Bazuar nga sa më sipër njësia e prokurimit në respekt të ligjit “Për prokurimin Publik”, kërkon që operatorët ekonomik ofertues të zhvillojnë të gjitha proceset e punës në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe vënia e këtij kriteri ka për qëllim njohjen e kapaciteteve organizative, pajisjet dhe makineritë, reputacionin dhe besueshmerinë duke garantuar njëkohësisht autoritetin kontraktor për zbatimin me sukses të kontratës dhe në kohë.

2.3.13 Për të vërtetuar se shërbimet, objekt prokurimi plotësojnë kërkesat e cilësisë, shoqëritë ofertuese duhet të paraqesin certifikata të vlefshme, ose ekuivalentet e tyre, të cilat duhet të jenë të lëshuara nga organizma ndërkombëtare ose shoqëri të akredituara në Republikën e Shqipërisë, si dhe të cilat duhet të jenë të vlefshme në datën e hapjes së procedurës së prokurimit publik, si më poshtë:

- Çertifikatën ISO 14001:2015, “Për sistemin e menaxhimit mjedisor” e vlefshme ose ekuivalent.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, “Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor” të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, dhe nenin 39, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar. Për vetë natyrën e veçantë dhe delikate, dhe përmasat e objektit të kontratës që do të prokurohet si dhe afatit për zbatimin e saj.

Kjo certifikatë lidhen ngushtësisht me objektin e kontratës përsa kohë do të pranohet edhe certifikata ekuivalente të tyre dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës. Referuar në nenin 79 të ligjit 162/2020, parashikohet se autoriteti kontraktor mund të kërkojë certifikata, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë, përfshirë edhe standardin për menaxhimin e mjedisit për sa kohë që veprimtaria e tyre ka ndikim të drejtëpërdrejtë në mjedis.

ISO (Organizata Ndërkombëtare e Standardizimit) është një organizatë me anëtarësi e pavarur, jo-qeveritare dhe zhvilluesi më i madh në botë i Standardeve Ndërkombëtare, nga 163 vende të botës. ISO publikon më shumë se 19500 Standarde Ndërkombëtare, të cilat mbulojnë pothuajse çdo fushë industrie, nga teknologjia te siguria ushqimore, bujqësia e shëndeti. Në nivel botëror shoqëritë ndjekin adoptimin e standarteve të cilësisë me qëllim që të jenë të respektuar nga

klientet e autoritetet shtetërore dhe të ndërtojnë bashkëpunim të qendrueshëm me avantazhe reciproke.

➤ **ISO 14001-2015 (Sistemin e menaxhimit të mjedisit e vlefshme) ose ekuivalent.**

Ky certifikim shërben në lidhje me sistemet e menaxhimit mjedisor, me anë të së cilës garantohen mundësitë e identifikimit, vlerësimit dhe menaxhimit të aspekteve mjedisore të një subjekti me synim parandalimin e dëmtimit të mjedisit, respektimin e legjislacionit vendas në lidhje me mjedisin dhe ruajtjen e burimeve natyrore. Gjithashtu, ky certifikim fokusohet në njohjen e të gjitha aspekteve mjedisore dhe menaxhimin efektiv të pasojave të aktivitetit të subjektit, duke bërë të mundur të përmirësohet ndikimi i veprimtarisë së përgjithshme të subjektit në aspektin mjedisor .

Kjo certifikat është në përpjestim dhe i lidhur ngushtë me objektin e kontratës si dhe në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi. Referuar objektit të prokurimit në rastin konkret, njësia e prokurimit e ka parë të nevojshme që shoqëritë të jenë të certifikuara nga organizata ndërkombëtare të cilat garantojnë një nivel të pranuar të menaxhimit të mjedisit sa kohë që veprimtaria e tyre ka ndikim të drejtpërdrejtë mbi të.

2.3.14 Operatorët ekonomik ofertues, duhet të disponojnë në pronësi ose me qira, minimalisht mjetet e mëposhtme, për kryerjen e shërbimit të pastrimit, me qëllim realizimin e objektit të prokurimit, si më poshtë :

Nr	Emërtimi	Sasia
1.	Makinë teknologjike për heqje dhe transport mbeturinash nga kontenierët, me kapacitet mbajtës 10 – 11 ton, me vit prodhimi jo më poshtë se viti 2014, me ngarkim fundor dhe me presim mbeturinash, raport kompaktimi 1:4 – 1:6, -	2 (dy) copë
2.	Makinë për larjen e rrugëve me presion (autobot), me kapacitet mbajtës 8000 – 9000 litra, me vit prodhimi jo më poshtë se viti 2006.	1 (një) copë
3.	Makinë teknologjike vetëshkarkuese (kamionçinë), e hapur nga sipër – 1 (një) copë.	

4.	Kontenierë	280 copë
----	------------	----------

Të gjitha mjetet duhet të jenë në pronësi ose me qira, si dhe të jenë të shënuara në regjistra publike.

Ofertuesi duhet të paraqesë dokumentin që verteton rregjistrimin e mjetit, certifikatën e pronësisë, leja e qarkullimit, certifikatën e kontrollit teknik, siguracioni i mjetit, si dhe foto ku të jetë e dukshme targa e mjeteve të ofruara.

Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publike, duhet të paraqitet dokumentacion që vërteton pronësinë e tyre, si aktet e zhdoganimit në RSH ose faturat tatimore të blerjes, për ato mjete që janë marrë me qira këto dokumenta duhet të jenë bashkëlidhur kontratës së qirasë noteriale, e cila duhet të përfshijë të gjithë periudhën e kërkuar në dokumentat e tenderit, si dhe të jetë përcaktuar objekti i marrjes me qira, qëllimi dhe destinacioni i mjeteve së bashku me dokumentacionin provues të tyre.

Mjetet në pronësi duhet të shoqërohen me akt pronësie origjinal ose kopje të noterizuar shoqëruar me gjithë dokumentacionin e kërkuar, si dhe për ato me qira përveç dokumentave të mësipërme duhet të paraqitet kontrata e qirasë e vlefshme, deri në afatin e përfundimit të kontratës së shërbimit të pastrimit.

Çdo makineri duhet të jetë e shoqëruar detyrimisht me dokumentacionin e mësipërm të kërkuar në kërkesat për kualifikim.

Çdo ofertues, duhet të paraqesë dokumentacionin e kërkuar në kërkesat për kualifikim, lidhur me mjetet dhe makineritë teknologjike, si dhe ka detyrimin ligjor të provojë dhe vërtetojë kërkesën për kualifikim.

Kjo kërkesë për kualifikim, do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës përkatëse të dokumenteve standarte të tenderit, por ndërkohë çdo kandidat apo operator ekonomik ofertues duhet të paraqesë dhe dokumentojë dhe provojë përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak, dokumentacionin vërtetues të vetdeklaruar në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, çdo ofertues duhet të sqarojë dhe deklarojë hollësisht të gjitha mjetet që ka në pronësi për të plotësuar kërkesën për kualifikim, duke dhënë njëkohësisht edhe të dhënat konkrete si targa e mjetit, kapacitetin mbajtës të mjetit, si dhe

çdo dokumentacion që provon kërkesën për kualifikim. Në rastin e marrjes me qira, të sqarohet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit numër rep. dhe numër kol. dhe datë të kontratës noteriale të qiramarrjes, targën e mjetit, kapacitetin mbajtës, si dhe çdo dokumentacion që provon kërkesën për kualifikim.

Në kriteret e veçanta të kualifikimit në të gjitha rastet e kërkesave për makineritë teknologjike, stafin dhe personelin e kërkuar, disponimi i tyre dhe plotësimi sipas kërkesës për kualifikim, do të dëshmohet nëpërmjet formularit përmbledhës të vetëdeklarimit dhe këto dokumente të kërkuara në kriteret e veçanta të kualifikimit, do të paraqiten nga operatori ekonomik, përpara se AK të japë kontratën, si dhe duhet të jetë në dispozicion në çdo kohë për verifikim nga operatori ekonomik.

Në rast se operatori ekonomik pjesëmarrës në procedurë është i regjistruar në një vend të huaj, atëhere mjetet dhe makineritë duhet të jenë të vendosura në Republikën e Shqipërisë me rregjistrim të përkohshme cila vërtetohet nëpërmjet dokumentit hyrës ose një deklaratë nga institucionet shtetërore, si dhe të jetë shënuar saktë adresa e këtyre mjeteve dhe makinerive. Dokumentacioni tjetër, sipas legjislacionit në fuqi dhe kërkesës për kualifikim.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë mjetet dhe pajisjet që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Numri dhe lloji i makinerive dhe paisjeve është vendosur duke ju referuar zërave të shërbimit sipas specifikimeve teknike, grafikut të detajuar dhe kohëzgjatjes së shërbimit, Për të zbatuar kontratën, operatorët ekonomik duhet të përmbushin kapacitetet teknike të pajisjeve dhe aseteve të tjera fizike, për këtë janë përcaktuar edhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët. Nëpërmjet kapaciteteve teknike operatorët ekonomik vërtetojnë se zotërojnë aftësinë dhe kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative. Pajisje dhe mjetet e mësipërme janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve dhe të mundësisë së operatorit për përmbushjen me sukses të kontratës si dëshmi për mjetet dhe

pajisjet teknike. Numri i mjeteve/makinerive që nevojiten për realizimin e kontratës është përcaktuar bazuar në zërat e shërbimit.

Nga ana e autoritetit kontaktor vendosja e këtij kriteri është në përpjestim të drejtë me natyrën, zërat e shërbimeve dhe vlerën e kontratës.

Konkretisht :

1- Makinë teknologjike për heqje dhe transport mbeturinash nga kontenierët, me kapacitet mbajtës 10 – 11 ton, me vit prodhimi jo më poshtë se viti 2014, me ngarkim fundor dhe me presim mbeturinash, raport kompaktimi 1:4 – 1:6.

Në zonën I që është qyteti i Kuçovës, sipas analizës së kostos është parashikuar se në një ditë gjenerohen 18.2 ton mbetje. Ky shërbim për qytetin e Kuçovës është parashikuar të kryhet 6 (gjashtë) ditë në javë. E djela është ditë pushim.

Në zonën II që është Njësia Administrative Perondi dhe Kozare, sipas analizës së kostos është parashikuar se në një ditë gjenerohen 16.5 ton mbetje. Ky shërbim për zonën II është parashikuar të kryhet 3 (tre) ditë në javë. E djela është ditë pushim.

Në zonën III që është Njësia Administrative Lumas është parashikuar të kryhet 1 (një) ditë në javë.

Shërbimet e cituar më sipër janë parashikuar në Grafikon e shërbimit të pastrimit të hartuar nga autoriteti kontraktor.

Në vendimin Nr. 319, datë 31.5.2018 “Për miratimin e masave për kostot e menaxhimit të integruar të mbetjeve”, shtojca 1 “Udhëzues për llogaritjen e kostos për menaxhimin e mbetjeve”, në pikën 1.2 të saj “Për llogaritja e nevojës për investime kapitale”, parashikohet se;

- Tipi i kamionit për grumbullimin e mbetjeve (tonë) dhe çmimi (lekë). Kamionët tipikë për grumbullimin e mbetjeve janë vetëngjeshës me kapacitet 5 dhe 10 tonë. Këta kamionë sugjerohen për t’u përdorur në varësi të tipologjisë së njësisë. Normalisht, në një zonë rurale apo rrugë të ngushta urbane përdoret një kamion me kapacitet 5 tonë, ndërsa në një zonë urbane një tip kamioni me kapacitet 10 tonë. Numri i kamionëve varion bazuar në sasinë e mbetjeve për t’u mbledhur dhe numrin e turneve të nevojshme për çdo kamion. Kapaciteti aktual i ngarkimit për një përbërje mikse mbetjesh është rreth 85% të kapacitetit total mbajtës të kamionit (p.sh., një kamion 10 tonësh mbushet deri në $10 \cdot 85\% = 8,5$ tonë).

Bazuar nga sa më sipër argumentuar, njësia e prokurimit gjykon se kriteri i mësipërm për disponimin e dy mjeteve teknologjike me kapacitet mbajtës 10 – 11 ton nga ana e ofertuesve, është një kërkesë minimale dhe garanton AK për zbatimin e kontratës me sukses.

Në lidhje me vitin e prodhimit të mjeteve njësia e prokurimit gjykon se;

Është qëllim i AK se kontraktuesi duhet të ndjekë praktika të shëndosha të biznesit dhe të përdorë teknologji të avancuar dhe të përshtatshme si dhe metoda të sigurta. “Kujtojmë se këto kushte janë parim i pranuar ndërkombëtar tregtar që rrjedh nga parimi i konkurrueshmërisë së vlerave e produkteve që sjellin zhvillim dhe përmirësim të kushteve të jetesës së komuniteteve. Me vitin e mjeteve teknologjike të kërkuar në këtë shërbim AK kërkon standartet me të mira të mundshme dhe me të avancuara/ të reja .

Në lidhje me vitin e prodhimit të mjeteve, AK gjykon se kërkesa e mësipërme është në proporcion me natyrën dhe volumin e kontratës, i shërben njëherazi jo vetëm proceseve të punës së parashikuar por njëkohësisht edhe ndikimit të tyre në mjedis.

Lidhur me mjetin - Makinë për larjen e rrugëve me presion (autobot), me kapacitet mbajtës 8000 – 9000 litra, me vit prodhimi jo më poshtë se viti 2006, njësia e prokurimit gjykon se në preventivin përmbledhës të shërbimeve është parashikuar në Nr 7 lagia e rrugëve. Akoma më tej në grafikun e shërbimeve të hartuar nga autoriteti kontraktor është parashikuar ky shërbim të kryhet 320 herë në vit, dhe konkretisht për periudhën Mars – Prill dhe Shtator – Tetor do të ofrohet 1 herë në dy ditë, pra 60 herë në vit, dhe për periudhën Maj – Shtator do të ofrohet 2 here në ditë, ku dita e martë do të jetë pushim dhe korrespondon me 260 herë në vit. Në lidhje me vitin e prodhimit të autobotit, AK gjykon se kërkesa e mësipërme është në proporcion me natyrën dhe volumin e kontratës, i shërben njëherazi jo vetëm proceseve të punës së parashikuar por njëkohësisht edhe ndikimit të tyre në mjedis. Është gjykuar nga AK se për autobotin është më i pranueshëm viti i prodhimit jo më pak se 2006 për arsye se periudha e tij e shërbimit është disa muaj në vit, ndryshe nga mjetet teknologjike që do të shërbejnë çdo ditë në qytet, ku ndikimi i tyre në mjedis është i drejtëpërdrejtë.

Lidhur me mjetin - Makinë teknologjike vetëshkarkuese (kamionçinë), e hapur nga sipër – 1 (një) copë, njësia e prokurimit gjykon se nevojitet për të gjitha proceset e heqjeve të mbetjeve inerte të cilat nuk mund të hiqen nga 2 mjetet teknologjike me ngarkim fundor dhe me presim mbeturinash, raport kompaktimi 1:4 – 1:6, dhe konkretisht në zërin 6 të preventivit përmbledhës ku është parashikuar heqjet e mbetjeve inerte dhe të biodegradueshme zona I dhe zona II.

Lidhur me - Kontenierë 280 copë

Lidhur me kërkesën e mësipërme, njësia e prokurimit është bazuar mbi analizës e kostos të përgatitur nga autoriteti kontraktor për Bashkinë Kuçovë dhe Njësitë Administrative Perondi, Kozare dhe Lumas.

Operatorët ekonomik ofertues duhet të disponojnë një nr minimale prej 280 kontenierësh për të mbuluar gjithë zonën me këtë shërbim, e cila është e nevojshme dhe jetike për zbatimin e kontratës objekt prokurimi dhe në përputhje dhe vëllim të plotë me të duke garantuar njëkohësisht autoritetin kontraktor që kontrata do të zbatohet me sukses të plotë.

2.3.15 Operatorët ekonomik ofertues, me qëllim që autoriteti apo enti kontraktor të krijojë besueshmërinë për operatorët ekonomikë ofertues, duhet të paraqesin detyrimisht në tender:

- Deklaratë me shkrim nga Administratori i shoqërisë që autoriteti apo enti kontraktor rezervon të drejtën të kryejë në çdo kohë verifikimin fizik të disponueshmerisë së mjeteve me ose pa paralajmërim paraprak, si dhe të bëjnë deklarimin e adresës së saktë të vendndodhjes së mjeteve teknologjike, me qëllim verifikimin e tyre në rast nevojë nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave (KVO).
- Deklaratë me shkrim nga Administratori i shoqërisë se makineritë teknologjike të kerkuara në kërkesat për kualifikim, nuk janë të angazhuara në kontrata te tjera, dhe në asnjë sipërmarrje tjetër publike apo private.
- Deklaratë me shkrim nga administratori i shoqërise ofertuese që i gjithë informacioni dhe dokumentacioni i paraqitur ne procedurën e prokurimit është i saktë, si dhe nuk përmban të dhëna të rreme për qellime kualifikimi.
- Deklaratë me shkrim nga Administratori i shoqërise ofertuese që autorizon autoritetin apo entin kontraktor të bëjë verifikimet përkatëse mbi të gjithë dokumentacionin e paraqitur në këtë procedurë prokurimi, pranë çdo organi apo institucioni ose autoriteti ose shoqëri që i ka lëshuar ato, në rast se që autoriteti apo enti kontraktor e gjykon të nevojshme.

- Deklaratë me shkrim nga Administratori i shoqërise ofertuese që merr përsipër me shpenzimet e veta dhe është dakort që të paraqesi pranë autoritetit apo entit kontraktor, mjetet teknologjike të kërkuara në dokumentet e tenderit, në rast se do të lindi nevoja për verifikimin e tyre përpara shpalljes së klasifikimit/njoftimit të fituesit paraprak.

Të gjitha deklaratat e mësipërme, duhet të jenë dhe të paraqiten në tender origjinale ose fotokopje të noterizuara, si dhe të nënshkruara nga Administratori i shoqërisë ofertuese, apo personi përkatës përgjegjës i ngarkuar me ligj.

Të gjithë operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin detyrimisht në tender, të gjitha deklaratat e kërkuara në kërkesat për kualifikim.

Të gjitha deklaratat e paraqitura në tender, duhet të jenë detyrimisht sipas përcaktimit të bërë në dokumentet e tenderit.

Mosparaqitja e deklaratave në formën dhe mënyrën e kërkuar në kërkesat për kualifikim, përbën kusht për skualifikim të ofertuesit nga procedura e prokurimit.

Paraqitja apo dhënia e informacionit të rremë, përbën kusht për përjashtimin e të gjithë ofertuesve që do të paraqesin informacion dhe dokumentacion që përmban të dhëna të rreme për qellime kualifikimi.

Në plotësimin e deklaratave, ofertuesit duhet të plotësojnë dhe të japin të dhënat e sakta të kësaj procedure prokurimi, si të paktën objektin e prokurimit, autoritetin kontraktor dhe numrin e Referencës së kësaj procedure prokurimi.

Ky kriter duhet të plotësohet sipas Legjislacionit në fuqi, si dhe duhet të jenë në momentin e njoftimit të fituesit paraprak të plotë dhe sipas kërkesave për kualifikim.

NJËSIA E PROKURIMIT